



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË
KRYETARI

Nr. 148 Prot.,

Datë 07. 05. 2024

VENDIM

Nr. 1, Datë 07.05.2024

**“Për
përfundimin e procesit të përditësimit dhe depozitimit të dokumentacionit ligjor të
shoqatave të kineastëve pranë QKK”**

Në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996, “Për kinematografinë”, të ndryshuar, akteve nënligjore në zbatim të tij, ligjit nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, të ndryshuar, si dhe shkresës nr. 138 Prot., datë 25.04.2024, pasi u shqyrtua dokumentacioni ligjor i depozituar nga shoqatat e kineastëve deri në datën 2.05.2024

KONSTATOVA:

Kanë depozituar dokumentacionin ligjor të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur, shoqatat e kineastëve si më poshtë:

1. Shoqata e Kineastëve Shqiptarë “LUMIERE”, Kryetar z. Joni Shanaj;
2. Shoqata e Kineastëve Shqiptarë, Kryetar z. Ndriçim Xhepa;
3. Shoqata e kineastëve të Rinj “Belmond”, Kryetar z. Dionis Papadhimitri;
4. Shoqata “Universal Albanian Cinema”, Kryetar z. Pluton Vasi;
5. Shoqata “Albanian Producers and Filmmakers Association”, Kryetar z. Dritan Huqi;
6. Shoqata “Albanian Woman in Audiovisual”, Kryetare znj. Sabina Kodra.

Nuk kanë paraqitur dokumentacionin ligjor të kërkuar shoqatat e kineastëve si më poshtë:

1. Shoqata “Lidhja e kineastëve të filmit dokumentar”;
2. Shoqata “Krijuesit e Animacionit Shqiptar – Albanimacion”.

Sa më sipër,

VENDOSA:

I. Shoqatat e kineastëve që kanë të drejtë të ushtrojnë kompetencën e tyre ligjore për propozimin dhe zgjedhjen e këshillave miratues të projekteve që do të funksionojnë në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë në periudhën Maj 2024-Maj 2026, janë:

1. Shoqata e Kineastëve Shqiptarë “LUMIERE”;
2. Shoqata e Kineastëve Shqiptarë;
3. Shoqata e kineastëve të Rinj “Belmond”;
4. Shoqata “Universal Albanian Cinema”;
5. Shoqata “Albanian Producers and Filmmakers Association”;
6. Shoqata “Albanian Woman in Audiovisual”.

II. Ngarkohet Drejtoria e Projekteve me komunikimin e këtij Vendimi tek subjektet e interesuara, si dhe në faqen zyrtare të internetit të institucionit.

Ky vendim hyn në fuqi datën e nënshkrimit të tij.



Pasqyrë përmbledhëse e dokumentacionit të depozituar nga shoqatat e kineastëve deri në datën 02.05.2024

Nr.	Emri i shoqatës	Dokumentacioni i depozituar në QKK	Vërtetim zyra regjistrimit të OJF-ve	Aktet e ndryshuara	Vërtetim për depozitim e akteve në gjykatë	Lista e anëtarësisë e përditësuar	Aktet në fuqi (Vendim /statut)
1.	Shoqata e Kineastëve Shqiptarë “LUMIERE”	Nr. 137 Prot., datë 25.04.2024	Datë 29.04.2024	Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme datë 09.04.2024.	Datë 26.04.2024	Po	Po
2.	Shoqata e Kineastëve Shqiptarë	Nr. 124 Prot., datë 12.04.2024	Datë 12.04.2024	Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme datë 30.04.2024.	Datë 02.05.2024	Po	Po
3.	Shoqata e kineastëve të Rinj “Belmond”	Nr. 136 Prot., datë 24.04.2024	Datë 26.04.2024	Vendim i Asamblesë së Përgjithshme datë 22.02.204 (fotokopje).	Datë 24.04.2024	Po	Po
4.	Shoqata “Universal Albanian Cinema”	Nr. 117 Prot., datë 08.04.2024	Datë 28.03.2024	Vendim i Asamblesë së Përgjithshme, Procesverbal i mbledhjes së Asamblesë datë 29.03.2024,	Datë 8.04.2024	Po	Po
5.	Shoqata “Albanian Producers and Filmmakers Association”	Nr. 120 Prot., datë 11.04.2024	Datë 26.03.2024	Vendime të Asamblesë së Përgjithshme, deklarata noteriale, Procesverbal datë 09.04.2024	Datë 9.04.2024	Po	Po
6.	Shoqata “Albanian Woman in Audiovisual”	Nr. 114 Prot., datë 04.04.2024	Datë 23.11.2023	Nuk ka paraqitur akte të ndryshuara, pasi vendimi i fundit i gjykatës për zgjedhjen e forumeve drejtuese të shoqatës daton 16.05.2023.	Nuk ka paraqitur vërtetim për depozitim e akteve në gjykatë, pasi nuk ka nevojë për rinovim të akteve	Po	Po

Nuk kanë paraqitur asnjë dokumentacion:

Shoqata “Krijuesit e Animacionit Shqiptar – Albanimacion”

Shoqata “Lidhja e kineastëve të filmit dokumentar”